



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DREJTORIA**

*Adresa: Terminali Center, Kthesa e Kamzës, pranë spitalit "Hygeia", Kodi Postar 1001,
Tel&Fax 042 222 315, www.postashqiptare.al*

VENDIM

Nr 411 Dt 28/12/2016

Mbi

“Miratimin e tarifave të dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar”

Drejtoria e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a. në mbledhjen e saj Dt 28/12/2016, pasi shqyrtoi dhe diskutoi relacionin e paraqitur **“Miratimin e tarifave të dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar”**, mbështetur në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloren dhe Statutin e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a,

VENDOSI :

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje ose CD) të jenë si më poshtë:
 - a. Deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë.
 - b. Mbi 10 fletë , për formatin A4, pagesa të jetë 5 (pesë) lekë/fletë.
 - c. Për informacionin e dhënë me CD, pagesa të jetë 60 (gjashtëdhjetë) lekë/CD.
2. Specialisti përkatës i sektorit, i cili do të përgatisë informacionin e kërkuar , në bashkëpunim me koordinatoren për të drejtën e informimit të institucionit, duhet të përlllogarisë koston totale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuesit /subjektit të interesuar.
3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuesi/subjekti i interesuar sipas faturës së arkëtimit (të miratuar), në llogarinë e institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, menjëherë i dërgohet kërkuesit/subjektit të interesuar informacioni (me postë), ose mund ta tërheqë atë dorazi.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Financiare, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORIA

MAJLIND	LAZIMI
ANGJELINA	KOLA
ENTEL	AGOLLI
VANGJUSH	ANDONI



The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp includes "DREJTORIA" at the top and "SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE" at the bottom. The center of the stamp contains the text "DREJTORIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE" and "KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT". Overlaid on the stamp are several handwritten signatures in blue ink, including one that appears to be "Angjela Kola".